

KOSOVIA

Ballina: Shpresa Memedi

Dr. Agim Bytyqi
gjithmonë
me popullin
dhe për popullin

E veçanta gazetare
Krenare Vokshi-Shala

Shqiptarja
që e kaloi jetën
virgjëreshë

Yjet shqiptarë
bëjnë gjëra
për t'u habitur


U bëra
prostitutë
që ta shkolloja
vajzën

Pse e mora
burrin pa e
parë kurrë

SHPRESA MEMEDI

*grua që shkëlqen në biznes,
vizionare, e guximshme*

Egzona Ahmetaj-Quni,
irizerja që ua prenë
flokët futbollistëve
të njohur





ZBRITJE



20%

30%

50%

NË TË GJITHA ARTIKUJT E QERAMIKËS

www.dinoqeramika.store



Pse është e veçantë Krenare Vokshi-Shala?

Autorja e emisionit televiziv "Personale" në TV Dukagjini, gjithmonë është aktuale si me përzgjedhjen e personazheve në emision, ku ka bashkëbisedues nga politika, arti, shkenca, mediet, po ashtu, edhe me rrjedhën e emisionit, i cili gjithnjë e më shumë po bëhet më i shikuar.

Autorja e emisionit, pa dyshim, di të prekë në tema

të ndjeshme, që zgjojnë kureshtjen e shikuesve të përcillet vazhdimisht.

Andaj, një autore e tillë, një moderatore si Krenare Vokshi-Shala meriton çdo lëvdatë.

Por, a dihet gjë për jetën e saj personale?

Dihet se është e martuar me biznesmenin e njohur Petrit Shalën dhe është nënë e dy fëmijëve.

Ku janë, ç'bëjnë...

Kush e bën Kidën të lumtur?

Këngëtarja e njohur, Kida, është mjaft aktive si me këngë ashtu edhe në rrjetet sociale.

"Jeta shumë e mirë kohëve të fundit", thotë ajo.

E, me këtë kuptojmë se këngëtarja po e shijon jetën, ani pse një pjesë e madhe e popullatës jeton në varfëri të skajshme.



Pse është shpeshtuar vrasja e nënave nga fëmijët e tyre?!

Ndryshimet që po ndodhin në shtetin e Kosovës janë dramatike. Ndër lajmet e pabesueshme kohëve të fundit është vrasja e nënave nga fëmijët e tyre...

Ngjarje tronditëse përditësohen nëpër rrjete sociale e tabloide, duke lënë pa tekst njerëzit e moshës së vjetër, të rritur e edukuar në sistemin ku respekti për prindërit ishte i plotë. Është shumë tmerruese kur fëmija që është rritur në barkun e nënës privon jetën e saj për interes të pakuptimtë, krahasuar me atë se nuk ka pasuri më të madhe se nëna...

NËNA BËN GJITHÇKA PËR FËMIJËN, E FËMIJA E VRET!

Se çka është në gjendje të bëjë një nënë, ka shumë shembuj gjatë historisë njerëzore...

Ka edhe këngë të shumta që tregojnë se një nënë i duket pak edhe kur ia jep fëmijës syrin a veshkën, kur i jep jetën dhe gjithçka që i shërben pasardhësit të saj të mbijetojë.

Tregimet për nënat janë të ndryshme dhe të dhimbshme. Zakonisht, gjithçka

për nënat zbulohet pas vdekjes së tyre. Atëherë kur është vonë për gjithçka...

TREGIMI PËR DJALIN E VETËM...

Një nënë e kishte pasur një djalë të vetëm. Kishte jetuar në varfëri të skajshme, shpesh pa bukë e pa gjërat më të imta të jetës në shtëpi.

Tërë natën, edhe pse ishte vetëm me njërin sy, ia qepte djalit rrobat në dritën e llambës së vajgurit, madje duke e ulur fitilin e saj në minimum, për ta ruajtur edhe për nesër.

Dhe, duke bërë shumë për djalin e saj, ajo e nisi për në shkollë me lot në sy.

E, kur djali u rritë, i tha nënës të mos vinte në shkollë te mësuesi, sepse i vinte inati nga shokët se nëna e tij ishte e verbër në njërin sy...

Andaj, kur u rritë, vendosi të shkonte larg shtëpisë, të punonte dhe të martohej. Si i ri gjeti punë në një familje që i kishte dy djem. Por, një ditë zihet me djalin e madh të zotërisë dhe e largojnë nga puna. E, po atë natë nëna e kishte parë në ëndërr të birin me probleme dhe e luti Zotin ta mëshironte të birin e saj dhe t'ia gjente një punë të mirë, që të mos vuante si në fëmijëri.

Lutja e nënës kishte arritur në vendin e duhur dhe djali i saj kishte gjetur punë te një pronar nga Stambolli.

Ai e kishte vetëm një vajzë.

I tha djalit të bëhej ortak në tokat e tij me portokaj e pemë.

E, djali e pranoi ofertën.

Dhe, teksa pasaniku plakej, i thotë djalit:

"A pranon ta marrësh për grua vajzën time?".

Djaloshi, pa u hamundur pranoi.

SI U ZHGËNJYE NËNA NË DJALIN E SAJ?

E, nëna, duke pasur mall për të birin, një ditë vendosi ta kërkojë djalin e saj. Dhe, kur mësoi se ku gjendet, vendosi ta vizitojë e të bindej nëse ai kishte ndryshuar, nëse do e pranonte si nënën e vet ashtu siç ishte...

Andaj, kur arriti në shtëpinë ku tash jetonte, djali, posa e pa, i tha: "Kthehu kah ke ardhur dhe mos më turpëro, sepse tash jam burri i vajzës më të pasur në këtë rajon!".

Dhe, pa një e pa dy u kthye prapa...

Por, kuptohet, me zemër të thyer...

E, kur i erdhi koha të vdiste, e luti djalin e fqinjit ta shkruante një letër dhe ta ruante nëse ndodh të kthehej djali i saj.

E, kur në zemrën dhe mendjen e të birit kishte "trokitur" malli për nënën, vendos ta vizitonte.

Kur arrin në shtëpinë e lindjes, shtëpia ishte pa kulm. Oborri ishte mbushur bar e therat.

Nëna nuk ishte askund...

Trokiti në derën e fqinjit të parë. Ai i tregoi se nëna e tij kishte vite e vdekur. I tha se ia kishte lënë një letër.

"Kur ti ishte fëmijë t'ia qepja rrobat e shqyera nën dritën e llambës me vajguri.

Ta sigurova bukën që të mos flesh i uritur. Bëra çmos të rritesh...

Dhe, kur u rrite ike nga unë!".

S. Krivaça

remos® KA PUNË PËR TY!



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Në kontaktoni në Info@remos-restaurants.de



[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

A e meriton Kosova të ndëshkohet?

Ka kohë që presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duket në publik përmes urimeve ndaj të tjerëve. Ajo i dërgoi urime edhe Spanjës për presidencë të BE-së, edhe pse Spanja nuk e ka njohur Kosovën dhe as që e ka në plan ta njohë!

Kryefjala zyrtare e presidentes çdo ditë ndërlidhet me diçka që nuk prek esencën e problemeve tona shtetërore. Politikat e saj shihen qartë se janë unike me Kurtin, e që ka rënë në kundërshtim me aleatët euroatlantikë.

Në VV vlerësojnë se "më mirë sanksionet sesa territorin...", pa ditur se territori nuk mbahet pa aleatë dhe se janë aleatët euroatlantikë që e kanë bërë Kosovën shtet funksional, duke e ndihmuar me ushtri, intervenim ushtarak, financim dhe njohje të shtetësisë së

Kosovës në arenën ndërkombëtare. E, në Kosovë momentalisht është krijuar hendeku ndërmjet shtetit dhe aleatëve.

Kosova po shënon degradim të shtetësisë, duke ecur kontra Perëndimit dhe për të parën herë pas lufte Kosova ka hyrë në fazën ndëshkuese.

PSE KOSOVA PO NDËSHKOHET?

Katër komunat veriore janë bërë shkak i krizës së shtetit. Zgjedhjet lokale në katër komunat veriore janë përkrahur ndërkombëtarisht, por këshillat e aleatëve kanë qenë që kryetarët e rinj të mos shkojnë në komuna me njësi speciale të policisë, siç veprroi qeveria jonë!

E, është e logjikshme se kryetari i komunës nuk mund ta kryejë mandatin duke u mbyllur në komunë!

Është, gjithashtu, logjike se me kryetarë të rrethuar nga forcat speciale policore nuk ushtrohet funksioni i të parit të komunës.

Andaj, duke qenë të bindur se do të ketë zgjedhje të reja që pranon edhe Presidentja e Kryeministri, shtrohen

pyetjet:

Pse duhej të rrezikohej siguria në veri? Pse të përdoret policia speciale në komunat veriore?

Pse kryetarët mbyllen në objekte dhe qëndrojnë në to kur dihet se nuk funksionon asgjë?

Pse duhej t'u jepej hapësirë bandave kriminale të Serbisë, e që mezi presin të ndodhë ndonjë tollovi?

Pse të krijohet krizë në veri, e që sjell gjendjen për të organizuar ndonjë konferencë ndërkombëtare që mund ta rikthejë Kosovën në pikën zero?

Por, mbase, Kurti me sjellje të tilla dëshiron t'i nënshtrojë SHBA-të, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Francën dhe shtetet e tjera të Quintit, e edhe Shqipërinë madje, duke rrahur gjoks "ja kush jam unë"!

Dhe, duke qenë në kundërshtim me aleatët euroatlantikë, qeveria Kurti me Presidenten Osmani po e rrezikojnë sovranitetin e shtetit.

Andaj, sanksionet veç kanë filluar, e pritet edhe regres në integrimin e FSK-së në NATO, e që veç është bërë e ditur nga aleanca.

Safet Krivaça

PSE ASKUSH NUK DEL I GJALLË NGA JETA?



...dielli është i madh dhe ndriçues, por prapë e lë gjysmën e botës në terr. Kjo do thotë, sado e madhe të jetë mirësia në këtë botë, largësia do të ekzistojë.

Çfarë më habit?

Njeriu!

Është i shqetësuar për të tashmen.

Pse?

Ai nuk jeton dot as sot, as nesër.

Ai jeton sikur nuk do të vdesë kurrë

dhe vdes pa jetuar kurrë si duhet.

Eh, vjen një ditë dhe gjithçkaje i vjen fundi...

Prandaj, mos e merr jetën aq seriozisht. Askush nuk ka dalë i gjallë prej saj, prej jetës.

E ne, që e shajmë jetën, nuk e kuptojmë se e shajmë veten tonë, sepse jemi ata që e bëjmë jetën të tillë.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Në ballinë

Shpresa Memedi është një nga shqiptaret e suksesshme të Diasporës, meqë sukcesi i saj në fushën e biznesit është i admirueshëm.

Një grua vizionare, e guximshme, e bukur.

E lindur në Maqedoninë e Veriut, por fëmijërinë dhe rininë i ka kaluar në Zvicër.

Shpresa është e apasionuar pas sportit dhe që në fëmijëri ka luajtur tenis, madje në mënyrë profesionale.

Dhe, falë talentit, ka pasur perspektivë të mirë për një karrierë të suksesshme në këtë sport.

Por, fatkeqësisht, ëndrra nuk iu bë realitet, meqë u përfshi në një aksident që e la të paaftë të luajë tenis.

Por, jeta kishte rezervuar suksese të tjera për Shpresën. Ajo sot është grua që shkëlqen në biznes.



Shpresa Memedi,
*grua që shkëlqen në biznes,
vizionare, e guximshme*



Shpresë, si mund të të njohim më shumë?

- Jam e lindur më 1 Maj 1986, në Gostivar. Fëmijërinë dhe rininë i kam kaluar në Zvicër, konkretisht në komunën Bischofszell. Për momentin jetoj në komunën Bottighofen, në liqenin e Konstancës.

Cili është kujtimi që ende qëndron i freskët nga fëmijëria juaj?

- Sa më kujtohet, fëmijëria ime ka qenë shumë e bukur. Si familje shqiptare në migrim, në shtet të huaj dhe me kulturë të ndryshme nga e jona, megjithatë, ia dola të ambientohem në shoqëri, si në shkollë ashtu edhe në jetën e përditshme.

A je sot ajo që ke dashur të jesh gjithmonë?

- Pa dyshim, po. Kisha vizion që në moshë të re, sepse gjithmonë e kisha një ide të qartë për jetën që doja të bëja.

Si e kujton rininë e hershme, ëndrrat e asaj kohe?

- Kam qenë entuziaste për tenis që në fëmijërinë time të hershme...

Pra, jeni marrë me tenis, sport jo shumë shqiptar, apo...?

- Në moshën 10-vjeçare shkova në turne tenis. Pikërisht në ato evenimente fitova paratë e mia të para me sport. Dhe, falë talentit tim, kam pasur perspektivë të mirë për një karrierë në këtë drejtim.

Cilat ishin arritjet tua në tenis?

- Arrita të marrë pjesë në disa evenimente, në të cilat ia dola me sukses dhe fitova paratë e mia të para në këtë sport.

Pse nuk e vazhdove?

- Fatkeqësisht, kjo ëndërr m'u shkatërrua, meqë isha e përfshirë



në një aksident, e që më la të paaftë të luaja tenis.

Mund të flasim pak për shkollimin tuaj?

- Shkollimin e fillova në një trajnim klasik, si nëpunëse tregtare në një zyrë revizori.

Jeni specialiste e financave dhe kontabilitetit. Pse kjo zgjedhje?

- Më pas fillova trajnimin e mëtejshëm për t'u bërë specialiste e financave dhe kontabilitetit, duke përfituar një certifikatë federale. Për më tepër, vendosa të marrë pjesë në disa kurse të mëtejme trajnimi në shkollën teknike për ekspertë në konsulencën e besimit dhe menaxhimit.

Ju njohin dhe u përshkruajnë si femër model, lidere. Ke qenë gjithmonë kështu?

- Edhe kur isha nxënëse, më pëlqente ta drejtoja punën ekipore. Për mua, e veçanta e një pozicioni të tillë është se mund të nxjerrë në pah dhe të promovoj pikat e forta individuale të çdo personi.

Për më tepër, isha në gjendje të përballoja me shumë përgjegjësi dhe të tregoja sjellje të përshtatshme.

Dhe, gjatë kohës si praktikante, ndihesha sikur të isha pronare e kompanisë.

Prandaj, edhe në këtë pikë ndjeva nevojën për të bërë një ndryshim. Gjithmonë kam dashur ta avancoj kompaninë time të trajnimit me ide kreative.

Për shembull, duke dizajnuar në mënyrë inovative softuerin tonë të sistemit ose duke krijuar struktura të reja të kompanisë. Këto cilësi rezultojnë në faktin se menjëherë pas përfundimit të shkollimit më dhanë një pozicion menaxhimi. Pas një kohe të shkurtër ma lejuan të merrja mandatin e menaxhuesit dhe, së fundi, por jo më pak e rëndësishme, mora timonin e kompanisë.

Përveç kësaj, kam qenë dhe jam e paepur për projekte të reja. Edhe atëherë, sapo isha në gjendje t'i qasja një detyre si një çështje rutinë, kërkoja detyra të reja.

Sot, cila është, saktë, puna juaj?

- Drejtoj firmën "360 Clean & More", e cila merret me pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve shtëpiake, si dhe të mjeteve lundruese. Jam aksionare në një firmë, e cila merret me shitblerje dhe konsulencë.

Cili është sukcesi yt më i madh në fushën profesionale?

- Sukcesi im më i madh në fushën profesionale është që jam zgjedhur një ndër tri gratë më të suksesshme në menaxhimin e firmave në Kantonin Turgau.

Formula e suksesit?

- Jam ambicioze në punë, e pavarur, vizionare. Suksesin time e kam arritur me shumë sakrificë në punë dhe më pëlqen të rrezikoj derisa ta arrij qëllimin e caktuar.

Kujt do i falënderohesh sot?

- Së pari, u falënderohem të gjithë punëtorëve, pa të

cilët nuk do isha këtu ku jam.

Dhe, në fund, nënës dhe djalit tim, Dijarit.

Ju, ndonëse jeni shumë e angazhuar, dukeni përherë bukur. A ka rëndësi pamja e jashtme në jetën tuaj?

- Normalisht, kur kam takime biznesi ose kur udhëtoj jashtë shtetit për takime, i kushtoj vëmendje të jashtëzakonshme pamjes së jashtme. Ndërkaq, në përditshmëri jam shumë e thjeshtë, meqë edhe merrem me sport.

Shpresë, cilat janë elementet që i duhen një femre për të qenë e suksesshme?

- Të jetë e pavarur, e fortë mendërisht, të mendoj pozitivisht, të mos ketë frikë dhe të rrezikojë.

Po, jeta juaj private?

- Merrem me sport, udhëtoj shumë dhe planifikoj që vendbanimi im i tretë të jetë lbiza.

Personi pa të cilin nuk mundeni?

- Dihet, djali im, Dijari.

Diç që ka mbetur pa u thënë?

- I motivoj vajzat e reja që pa frikë ta ndjekin deri në fund ëndrrën e vet...

Nderim Neziri





KOSOVA AIRLINES eurokoha

flyksa.com | eurokoha.eu



Nëse mund të simbolizohet një mjek emblematik që aq shumë e do popullin dhe lidhet me popullin nëpërmjet jetës, punës e veprës, dr. Agim Bytyqi, nga Ferizaj, është shembulli më i mirë të krahasohet me Migjenin e dhembjes njerëzore.

Migjeni prezantohet në popull nëpërmjet shkri-meve, ndërkaq Agim Bytyqi nëpërmjet kujdesit mjekësor dhe humanitetit, duke dhënë edhe nga xhepi i vet për shërimin e pacientëve.

Andaj, Agim Bytyqi, që mbushet energji pozitive nga lumturia e të tjerëve, sot është shembull unikat për mjedisin kosovar si duhet punuar me masën popullore.

Në luftë e në paqe me popullin dhe për popullin



Dr. Agim Bytyqin është lehtë ta gjesh në Ferizaj. Nuk ka qytetar në Ferizaj që nuk di të tregojë ku është ordinanca e doktor Agim Bytyqit, për faktin se ai gjatë tërë jetës është lidhur me popullin.

Mbi të gjitha, është mjek profesionist, me kualitete të jashtëzakonshme. Është humanist për nga detyra që kryen, duke mos i interesuar fatura e fitimit, e që nuk e gjen te asnjë mjek tjetër.

Është veteran i luftës së UÇK-së. Ka qenë ushtar dhe mjek i UÇK-së në Zonën Operative të Nerodimes, në Jezerc, gjatë viteve 1989-1999.

Ka punuar në shumë programe shëndetësore për popullin shqiptar të Kosovës, për shumë vjet pa pagesë, e pastaj vetëm me një 1 DM, kurse prej vitit 2017 nga dy euro për kontroll, e tash 3 euro, kurse mjekët e tjerë në ordinancat private pacientëve për kontroll u marrin, së paku, 20 euro.

I NDERUAR PARA LUFTE, I NDERUAR NË LUFTË, I NDERUAR VEÇMAS PAS LUFTE

Ordinanca e dr. Agim Bytyqit, "Tea", është spital më vete për nga prania e njerëzve

dhe vizitat ditore që mesatarisht arrin 100 pacientë në ditë, pa llogaritur vizitat nëpër shtëpia dhe vizitat e rastit që mund të jenë çdo kund dhe në çdo kohë.

Sidoqoftë, dr. Agim Bytyqi në Ferizaj njihet si emblema e mjekësisë, së paku, qe katër dekada.

I nderuar para lufte, i nderuar në luftë, e veçmas pas lufte, mjeku i popullit, Agim Bytyqi, radiolog, nuk ka ndryshuar qëndrimin ndaj masës.

Ai nuk i ka hyrë rrugës së profitit, si shumë mjekë të tjerë që mjekësinë e kthyen në kurriz të popullit, duke i shkelur rregullat dhe parimet.

SI E NISI PUNËN DR. AGIM BYTYQI?

E ka filluar punën e mjekut më 1984 në Shtëpinë e Shëndetit në Ferizaj, ku ka ushtruar profesionin deri në vitin 1990.

Në vitet 1990-1993 ka punuar mjek pa para dhe profesor në Shkollën e Mesme të Mjekësisë. Ka ligjësuar lëndën e Anatomisë patologjike.

Andaj, dy vende pune profesionale pa pagesë, Agim Bytyqin e kanë lidhur shumë herët me popullin.



Në vitin 1993 hapi ordinancën private "Tea" dhe u bë më i kërkuari i mjekësisë në Ferizaj e rrethinë.

Por, në vitet 1998-1999 ai iu bashkua radhëve të UÇK-së si ushtar dhe mjek në Spitalin Ushtarak në Jezerc të Ferizajt dhe u ka dalë në ndihmë mjekësore ushtarëve të UÇK-së dhe popullatës së asaj ane pa dallim.

"Në Jezerc kam punuar me koordinimin e kirurgut dhe mjekut Xheladin Reçica, që ishte udhëheqës i spitalit ushtarak në Jezerc", thotë dr. Agimi dhe shton:

"Në Jezerc ka qenë punë vështirë të punohet në të dy segmentet mjekësore, me popullin dhe të plagosurit, si dhe të rrahurit që vinin nga dhuna e forcave policore e paramilitare.

Krahas mungesës farmaceutike, ka qenë edhe mungesë e hapësirës adekuate, punë që bëhet vetëm duke e dashur profesionin dhe popullin. Ka qenë shumë vështirë të punohet, sepse popullata kishte nevojë të trajtohej në spitalin ushtarak, por edhe nëpër shtëpia a fushë ku ndodheshin... Kur shkova në Jezerc si mjek, e ndjeja veten më shumë si ushtar i UÇK-së. Atje mu plotësua shpirti me djem e burra që kishin dalë në mal ta çlironin vendin.

Kam takuar qindra ushtarë të UÇK-së. Por, momente të paharruara kam pasur me disa ushtarë që nuk kanë ditur çka është frika dhe që nuk e kanë matë jetën për vendin.

Të tillë kanë qenë Ahmet Kaçiku, Naim Beka, Driton Islami, Bajram Gashi dhe

Kemal Hetemi.

Por, njeriu që ishte legjendë e UÇK-së ka qenë Fetah Zogu ("Oso Kuka"). Ai edhe në kohën kur ishte i plagosur dhe i shtrirë në Spitalin Ushtarak në Jezerc, nuk donte të qëndronte pa armë!

Ka qenë njeri shumë i përgatitur për aksione diversant mbi armikun.

Dhe, sa herë e lypte nevoja që dikush të futej në kampin e çetnikëve, ai ishte Fetah Zogu...

Sidoqoftë, ishte modest në jetë e në luftë dhe shumë i dashur me njerëzit. Andaj, paraqitja aq modeste e një njeriu që kishte aq shumë suksese dhe trimëri në luftë, jepte të kuptosh se ai ishte njeri i madh, një karakter i fuqishëm luftarak me strategji eprori elitare, që nuk i dhimbsej asgjë vetëm të çlirohej Kosova.

Por, ka pasur edhe shumë njerëz të tjerë që nuk kanë kursyer asgjë për ta fituar luftën dhe të tillë kanë qenë edhe vëllezërit Sylejmani (Bajram e Gursel Sylejmani) nga Sadovina e Vitisë, me të cilët jam njohur në Ferizaj edhe para lufte dhe fati deshi të ishim bashkë edhe në Jezerc në UÇK. Kanë qenë të patrembur dhe kanë rënë në luftë një orë njëri nga tjetri. Megjithatë, kanë lënë shembull si luftohet për atdhe...

Kemi qenë katër mjekë në luftë në Jezerc, nipa të gjysh Idrizit dhe jemi marrë me shërimin e pacientëve në radhët e civile dhe ushtarëve dhe e kemi mbajtur spitalin me shumë përkushtim.

Andaj, falë punës që kemi bërë aty, kemi pasur besimin e shumë sponsorëve të firmave të mëdha, të cilët kanë ofruar shërbime për të sëmurët dhe të plagosurit.

Andaj, me këtë rast i falënderoj përjetë ata që kanë përfillur kërkesat e mia për shërimin e pacientëve në Zonën Operative të Nerodimes, në fshatin Jezerc.

Ata kanë paguar terapi të shtrenjta për pacientët me kërkesën time, e që ishte një bashkëpunim i singertë ndërmjet nesh, i ndërtuar mbi përvojat e singerta për popull", thotë ai.

MJEKU QË E MORI PATRIOTIZMIN NGA SAKRIFICAT FAMILJARE

Qysh si fëmijë, me origjinë nga fshati Sllovi e Lipjanit, Agim Bytyqi formoi individualitetin e karakterit të fortë nga sakrificat e familjes.

Gjyshi i tij, Idrizi, ishte në lëvizjen çlirimtare me Adem Gllavicën. Dhe, duke plotësuar ngjarjet e familjes me faktografinë e përjetimeve të tmerrshme, dr. Agimi thotë: "Gjysh Idrizin e kanë vranë në kufi me Greqinë. Ishte celulë e Adem Gllavicës.

Por, edhe nga ana e nënës kisha pasur të njëjtin fat: Gjyshi Bajrush Goga (babai i nënës) ishte vranë në Strugë, për punë të çështjes kombëtare. Andaj, meqë ishin të dy gjyshërit të vranë, shtëpinë tonë e ka frymuar patriotizmi dhe motivi për çlirimin e



Kosovës”.

Por, familja Bytyqi, e njohur për punë shëndetësore, njihet edhe nëpërmjet babait të Agimit, Ibrahimit, i cili ka punuar në Magurë që nga viti 1950, e më vonë në Lipjan, Shtime e Gjiilan. Sidoqoftë, veprimtaria patriotike për çlirim të Kosovës është fryma e familjes Bytyqi, për çka Agimi, si mjek, kishte rezonuar me kohë se mund të ishte i dobishëm, meqë e donte popullin dhe profesionin e mjekut. Agim Bytyqi ka specializuar në radiologji më 2003 dhe rreth specializimit thotë:

“Nuk kam dashur të specializoj në kohën e okupimit serb të Kosovës. Kam pasur qëndrim të paluhatshtëm, si kuadër i kërkuar profesional, të specializoj vetëm në shtetin e Republikës së Kosovës, kur ne t’i kemi organet tona dhe këtë e kam bërë në vitin 2003”.

Sidoqoftë, dr. Agim Bytyqi, mjek dhe radiolog, krahas punës me pacientë në ordinancën “Tea”, ka marrë pjesë në më shumë se 50 simpoziume shkencore të lëmit mjekësor, në po aq kongrese, takime shkencore e seminare në Kosovë, Ballkan, Evropë,

Azi dhe SHBA.

Është bashkautor i mbi dhjetë punimeve shkencore të karakterit ndërkombëtar në Zvicër. Ka qenë anëtar i Kryesisë së parë të Shoqatës së Mjekëve të Pavarur në Mollopolc; anëtar i Shoqatës së Radiologëve të Kosovës 2000-2002; kryetar i Shoqatës së Radiologëve të Kosovës 2003-2004, anëtar i kryesisë së Ultrazërit të Kosovës dhe kongresit të parë ultrasonografik në Kosovë. Gjithashtu, ka qenë anëtar i shoqatës së mjekëve kosovarë dhe shoqatave të tjera mjekësore në Evropë e SHBA, anëtar i Shoqatës së Mjekëve Radiologë të Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë dhe Evropës, ndërkaq kontribut dha edhe në vepra monografike dhe dokumentare, si, bie fjala, dokumentari për dr. Vesel Elezin, Monografia e Gjinnazit 1973-1977, Dokumentari “40-vjetori i Maturës së Gjinnazit”, për ta kompletuar me veprën dokumentare dhe tejet të vlefshme për shëndetësinë në Ferizaj, Monografinë “Shëndetësia e Ferizajt me rrethinë në shekullin XX”, që është një kontribut i tij lartë dhe shumë i çmueshëm për shëndetësinë ferizajase.

PSE DR. AGIM BYTYQI VENDOSI TË PUNOJË ME PAGESË SIMBOLIKE?

“Në vitet 90 mjekët serbë punonin për 50 DM në muaj.

Thashë: Pse edhe unë të mos bëj punë me çmim të lirë për popullin tim?!”. Nuk ka njeri që mund ta drejtojë gishtin kah unë e të thotë se i kam marrë para, apo që nuk e kam trajtuar me respekt të mjaftueshëm.


Nuk ka mjek veç meje që vizitën e pacientit e ka 3 euro. Por, kjo nuk është temë diskutimi e kësaj bisede, sepse për mua ka rëndësi si ta mjekoj pacientin e jo a i ka në xhep 3 eurot me m’i dhënë... Andaj, e mjekoj çdo kënd, pa marrë parasysh i ka apo nuk i ka 3 euro...

Në anën tjetër, ka pasur shumë raste kur pacientit ia kam blerë barërat vetë, sepse për mua me rëndësi është shërimi i pacientit e jo ana materiale... Në Ferizaj i njoh njerëzit mirë dhe e di kush ka e kush nuk ka...”, thotë dr. Agim Bytyqi.

(Përfundon në vazhdimin tjetër)

Safet Krivaça

Si ka pleqëruar me kanun Smajl Hyseni nga Jezerci?



Smajl Hyseni

Për dekada të tëra në Kosovë ka vendosur drejtësi kanuni i Lekë Dukagjinit. Njerëzit nuk kanë pasur besim në ligjin e pushtetit, që shpesh ka vendosur kontestin në favor të të fortit.

Ka pasur e ka akoma pleqnarë që kanë gjykuar dhe gjykojnë me kanun. Sa është ai real dhe sa i përshtatet kohës së shekullit XXI, flet Smajl Hyseni, i cili ka pleqëruar qindra raste...

Ai, në bisedën që e bëmë me të në janar të vitit 2006, pat thënë:

“Unë kurrë nuk kam pasur dëshirë të gjykoj me Kanunin e Lekë Dukagjinit, sepse gjithmonë jam frikësuar se po i hyjë ndokujt në hak.

Gjykimi me kanun ka mbetur si pasojë e mungesës së shtetit ligjor e i gjykatave. Kanuni ka mbuluar vakuumin ligjor dhe penal në Kosovë, gjyqin dhe institucionin e drejtësisë.

Mungesa e ligjit është zëvendësuar me të pleqëruarit e drejtësisë nga burrat nëpër oda.

Sepse, kur nuk ka shtet, ka odë! Kur nuk ka shi, bën edhe breshër!

Por, kanuni është i rëndë, sepse ta fikë

derën e shtëpisë dhe kjo më shumë ndodh në pagesën e krimit, kur dorasi paguan 60 lira gjakun! Dënimi nuk ka kuptimin ta lajë fytyrën e të dëmtuarit, as të ushqehet nga paraja e gjakut, por më shumë aplikohet si masë parandaluese e vrasjeve!”. Kështu e cilëson kanunin pleqnari Smajl Hyseni, nga Jezerci i Ferizajt, që jeton në Nerodime, e që ka pleqëruar në, të paktën, 14 komuna të Kosovës.

KUSH ËSHTË SMAJL HYSENI?

Smajl Hyseni, në kohën kur e bëmë bisedën, 78 vjeç, ka folur për veprimtarinë e vet rreth pajtimeve në oda, dënimet dhe përgjegjësitë e palëve, në rastet e aplikimit të pajtimeve me kanun...

Ai, në odën e vet të hapur për miq dhe të panjohurit, priste, si zakonisht, nëse dikush do t'i trokiste në derë, për ta ftuar në ndonjë pleqërim, apo mision pajtimi.

Ai është mësuar të jetë çdo ditë i angazhuar gratis, në misionin humanitar të zbatimit të Kanunit të Lekë Dukagjinit, për t'i ofruar ngatërrestarët dhe për ta vënë drejtësinë në vend, tek të gjithë ata që më shumë i besojnë fjalës së tij sesa asaj të gjyqit dhe institucionit.

Por, Smajl Hyseni nuk duket i lumtur dhe i gëzuar pse e ka këtë rol aq të rëndë shoqëror në pleqëri dhe thotë se, përkundër dëshirës, nuk mund të mos u përgjigjet ftesave të nevojtarëve, të cilëve u del gjumi në çdo kohë të natës për belatë, apo ngatërrestat e formave të

ndryshme...

“Unë e di se Kanuni i Lekës ka mbetur si pasojë e mungesës së ligjeve dhe institucioneve të shtetit tonë. Ku ka shtet institucional nuk ka nevojë për asnjë lloj kanuni, sepse ku ka Kanun nuk ka shtet juridik. Unë nuk kisha dashur të merrem me Kanunin, e aq më pak të dalë për të pleqëruar odë më odë dhe të mbyllem nga dy ditë derisa të gjej zgjidhjen e problemit.

Por, nevoja për të qenë në mision ndërmjetësues është shumë e madhe. Sot njerëzit akoma, në masë shumë të madhe, i besojnë gjyqit popullor dhe bindjeve se aty ku pleqërohet me Kanun ka drejtësi”, thotë Smajl Hyseni.

Ai, megjithatë, nuk duket i lumtur që merret me këtë problematikë tani, kur në këtë kohë Kosova po i bën institucionet e drejtësisë, të cilat për të janë të brishta, por me shumë interes për vendin dhe për popullin.

“Po të ketë drejtësi institucionale, Kanuni harrohet. Por, vetë fakti se në Kosovë përdoret akoma Kanuni, flet se sistemi i drejtësisë institucionale këtu është larg të drejtës gjyqësore.

Po, burrin e korit interesi, por edhe sistemin e drejtësisë e korit interesi dhe rryshfeti!

Unë kurrë nuk kam pranuar rryshfet e asgjë tjetër të formës së interesit për të ndarë drejtësi...

Prej kur kam qenë tetëmbëdhjetë vjeç kam filluar të pleqëroj dhe prej atëherë kam dalë përballë të gjithë burrave të disa

ggeneratave, e që kanë pleqëruar në oda. Dhe, deri këtu nuk më ka ngushtuar Zoti, që ta lë pa përfunduar ndonjë rast... Kam pleqëruar aso probleme që dikujt ia kanë pëlcitur zemrën, dikujt ia kanë derdhur lotin përjetësisht, e dikujt ia kanë shuar jetën...

Kam pleqëruar edhe aty ku ka pasur shumë pikëllim, por jam ndarë i lumtur, sepse i kam afruar njerëzit e hasmuar", thotë Smajl Hyseni për misionin e pleqërimit, i cili e përcjellë atë hiq më pak se gjashtëdhjetë vjet.

SI MERREN NË PYETJE PALËT E HASMUARA?

Një pamje e kuvendit të odave, në të cilat bëhet thirrja për një trajtim pajtimi të çfarëdo rasti të të ngatërruarve, bëhet vetëm në një mënyrë:

Së pari ftohen palët e hasmuara. Ata, paraprakisht, detyrohen të propozojnë nga dy dorëzanë (garantues), të cilët do ta përcjellin besnikërisht deri në mbyllje të çdo fjale, vendimi e procesi deri në mbyllje të kontestit.

Dorëzanët nuk duhet të jenë nga gjaku i palëve. Nuk mund të jenë njerëz që përfshihen në të drejtën e pushkës për ata që hyjnë në dorëzanë.

Secila palë duhet të ketë nga dy dorëzanë dhe misioni i dorëzanëve është t'i bartin dhe përcjellin obligimet dhe vendimet e pleqnarëve të kanunit.

Pasi të jenë siguruar dorëzanët, ftohen palët e kontestit në odë, të cilët i caktojnë kuvendarët dhe njëri prej kuvendarëve caktohet ta udhëheqë kontestin.

E, kjo është si një lloj prokurori gjyqësor... Para se t'ua japë fjalën palëve të hasmuara, ai u tregon atyre se prej këtij momenti, kur pleqtë e kanunit janë tubuar për ta zgjidhur kontestin, cilado palë që e sulmon palën tjetër dënohet me kod të veçantë, duke hyrë në borxh të paparashikuar material-financiar dhe kombëtar te burrat dhe kushdo që e thyen besën i jep llogari Kuvendit të Burrave, si një organ që merr vendime.

Në këtë mënyrë, kuvendi automatikisht i vendosë nën kontroll palët, duke përjashtuar edhe përdorimin e emocioneve, pavarësisht temperamenteve dhe dëmeve që kanë pësuar gjatë hasmërisë.

Pasi të pyeten palët e hasmuara nëse e kanë të qartë procesion që do të pasojë, udhëheqësi i Kanunit ua jep fjalën palëve të hasmuara, duke filluar obligativisht me palën e dëmtuar të parën në deklaram ta paraqet problemin, kundrejt burrave të tubuar dhe palës tjetër dëmtuese.

Gjatë kohës sa ai e paraqet ngjarjen, askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë gjatë atij akti, pavarësisht a po e flet apo jo të vërtetën.

Pasi ai ta ketë përfunduar fjalën, udhëheqësi i Kuvendit të Burrave, i jep fjalën palës tjetër dhe ai do ta paraqet fjalën deri në përfundim të fakteve.

E, kur të dy palët ta kenë paraqitur fjalën e të dhënave që kanë krijuar problemin, trupi udhëheqës u jep të drejtën palëve ta thonë gjithë atë që eventualisht kanë harruar ta thonë para burrave.

Dhe, kur kjo të përfundojë, kuvendarët i detyrojnë të gjithë të pranishmit ta braktisin odën dhe të qëndrojnë në dhoma të ndara, si dhe të kthehen në odë vetëm pasi të jenë ftuar nga Kuvendi i Burrave. Tubimin e lëshojnë edhe dorëzanët dhe vetëm në përfundim të pleqërimit trupi gjykues i thërret palët dhe dorëzanët, të cilëve ua konfirmon vendimin.

Vendimi është përfundimtar për të dyja palët, konform të drejtës së kanunit për problemin e caktuar.

Nga vendimi i burrave nuk ka kthim prapa, pa marrë parasysh pritjet që kishin palët.

Në secilin rast, njëra palë është më e pakënaqur se pala tjetër, por vendimi mbetet valid dhe në fuqi edhe nëse njëra palë lëshon fjalë, apo gjuan fjalë kundrejt burrave, diçka sikur në përfundim të seancave gjyqësore, ku pala e pakënaqur ofendon gjyqin.

Sidoqoftë, vendimin që marrin burrat nuk ka fuqi ta thyejë asnjëra palë.

Megjithatë, të pakta janë rastet kur të dyja palët ndahen të kënaqur, apo të mos reagojë njëra palë.

"Ka momente kur pala e pakënaqur na thotë se s'paskeni bërë gjë, e mund të ketë edhe nënçmime.

Por, ne zakonisht përmbahemi, sepse e dimë që dënimi është i rëndë dhe ndokujt mund t'ia lëmë sofrën me kripë, apo edhe

pa të, por ne shkojmë në synimin që hasmëria të mbyllet dhe faktori njeri të ruhet, kurse ana materiale shkon e vjen. Ne synojmë ta mbyllim çdo hasmëri që mund të sjellë gjak të ri dhe situata të rënduara", thotë Smajl Hyseni, pleqnar me karrierë gjashtëdhjetëvjeçare në pleqërim në Kosovë.

PËRBALLË BURRAVE TË MËDHENJ NË PLEQËRIM

Smajl Hyseni, nga Jezerci i Ferizajt, njo-

hësi më i mirë i Kanunit të Kosovë, thotë të ketë ndarë drejtësi përballë burrave eminentë në oda, si Mulla Ademit, Tahir Maliqit, Mulla Hamitit në Jezerc, Osman Mehmetit, Bajrush Sahitit dhe shumë të tjerë që nuk i kujtohen tani.

Smajl Hyseni di edhe për ndryshimet sociale të ngatërresave, duke i dalluar ato në kohë para lufte dhe pas saj.

Para lufte, sipas tij, kishte ngatërresa gjaku, ndërsa pas lufte, kryesisht, bëhet fjalë për probleme shoqërore të bashkëshortësive dhe femrave, që ai i përshkruan si krizë e moralit shoqëror.

PSE SMAJL HYSENI ISHTE NË SHËNJESTËR TË SERBËVE?

Smajl Hyseni një kohë të gjatë ka qenë në shënjestër të forcave serbe. Atë e kanë përcjellë për kohë të gjatë, në çdo lëvizje, pasi gëzonte respekt në popull. Dhe, duke përshkruar situatën e tillë me pak fjalë, Smajl Hyseni, thotë:

"Kemi pasur probleme të vazhdueshme me serbët, sepse ata ushqeheshin dhe frymëzoheshin me lisat e Car Dushanit në Nerodime, të cilët u rrafshuan pas lufte, për çka serbët kanë ngritur shumë pluhur".

Smajl Hyseni njihet në Ferizaj edhe për shkathtësi politike, si njohës i rrethanave dhe zhvillimeve dhe ka pasur lidhje me shumë kryetarë të komunës së Ferizajt, e që kanë marrë te ai modelin e zgjidhjes së problemeve, kur kryetarët janë gjetur në situata të pazgjidhshme...

Safet Krivaça

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play



BREZOVICA
HOTEL & SPA



REZERVO TANI!

+383 49 30 10 30

Përjetoni të jashtëzakonshmen në
1100 metra lartësi mbidetare
www.brezovicahotel.com

BOOM

*Të famshmit
që vdiqën
në mënyrë
misterioze*

*Pasionet
e yjeve
shqiptarë
bëjnë çka nuk
ua merr mendja!*

*Kush janë
nënat e
yjeve tanë?*

*Adelina Paloja,
sopranoja që
e prezantoi
Kosovën
në "Pantheon"
të Romës*

**Egzona
Ahmetaj-
Quni,**
*frizerja që ua prenë
flokët futbollistëve
të njohur*


Egzona Ahmetaj-Quni,

frizerja që ua prenë flokët futbollistëve të njohur

Egzona Ahmetaj-Quni është frizere për femra dhe berbere për meshkuj. E vetmja berbere e diplomuar, e cila ua ka prerë e rregulluar flokët shumë futbollistëve dhe personaliteteve të njohur.

I ka dy diploma të vlefshme që njihen si "CFC". Në sallonin e saj "Melisa Coiffure", që gjendet në Zvicër, përditë frekuentojnë kliente të ndryshme, femra të cilat zbukurohen nga duart e arta të Egzonës.

E lumtur, me energji pozitive dhe si përherë falënderuese, Egzona Ahmetaj-Quni shkëlqen edhe në këtë intervistë, ku shpalosë veten, punën dhe karrierën e saj.



Një prezantim i juaji?

- Jam Egzona Ahmetaj-Quni, nga komuna e Istogut, konkretisht nga Banja e Pejës, ku edhe jam e martuar dhe e kam familjen. Ndërkohë, bashkë me familjen që nga viti 1989 jetojmë dhe veprojmë në Zvicër, në kantonin Wallis.

Jeni frizere e njohur për femra dhe meshkuj. Si u lindi dëshira e pasioni për këtë zana?

- Si e vogël, ndoshta në moshën katërvjeçare, ia krehja dhe rregulloja nënës sime flokët dhe mbaj mend që gjithmonë më thoshte: "U bëfsh si Njomza, vajza frizere e Shyhrete Behlulit!". Pastaj, ishte edhe babai që më motivonte, më thoshte të bëhesha frizere, e t'ia preja flokët një ditë... Babai, po ashtu, gjithmonë më inkurajonte ta kisha një profesion, sepse, sipas tij, kështu do të isha e pavarur, do ta kisha paranë time. Profesionin e kam mësuar tek master "Ciro Coiffure", i cili më dha shumë vullnet për punë, për profesionin, ku edhe e kalova me nota shumë të mira prerjen e flokut për meshkuj e femra.

Prej vitesh e keni sallonin tuaj "Melisa Coiffure". Ku gjendet, si u ecë puna?

- Salloni im quhet "Melisa Coiffure", sipas emrit të vajzës sime. Gjendet në më të bukurin kanton, në mes të Wallisit, vend ku i kam familjen e shoqërinë. Sallonin e quajti kështu babai im. E kam hapur që shtatë vjet.

Është interesant se keni qethur edhe meshkuj, madje keni prerë e rregulluar edhe flokët e shumë futbollistëve të njohur, apo jo?

- Në fillim të profesionit ua kam prerë flokët shumë sportistëve të njohur, si, bie fjala, atyre të "FC Sion", "Red Ice" etj.

Po ashtu, kam prerë dhe rregulluar flokët e shumë personaliteteve të njohur, duke filluar nga avokatët, politikanët, arkitektët, policët etj.

Ndërkaq, tani në sallonin tim punoj me femra, si: extention, ngjyra, prerje, e shumë shërbime të tjera, për të cilat jam trajnuar



dhe aftësuar profesionalisht nga Wella, Lakme etj.

Kam kryer trajnime te Ajkunja, kur ishte edhe Kaci, por edhe shumë të tjera me rëndësi.

Duket që babanë e ke pikë të dobët. Flet me shumë dashuri për të. Pse?

- Po, sepse është kontribuesi më i madh, njeriu që më ka mbështetur pa kursim. Gjithmonë them se është babai më i mirë në botë.

Kujt i falënderohesh për arritjet?

- Fillimisht Zotit që ma dha shëndetin, talentin dhe motivin për punë, pastaj nënën, babanë, motrat, vëllanë, por edhe shefit tim të parë "Ciro Coiffure", mjaft i zoti dhe i famshëm për punën e tij. Një falënderim të veçantë për

bashkëshortin që e respekton profesionin tim...

Cili është pasioni juaj?

- Zanati im është pasioni im. Gjithashtu, kam dëshirë të flasë me njerëz dhe t'u ndihmoj atyre aq sa kam mundësi. Gjithmonë flasë me klientet e mia. Shpesh bëhem edhe psikologe e tyre. Dua që kur të vijnë te unë të ndihen rehat e të relaksuar...

Jeta private?

- Jam e martuar, nënë e lumtur e dy vajzave, Melisë dhe Dianës. Jam tejet e lidhur me familjen...

Për fund?

- Faleminderit për intervistën! Ishte kënaqësi imja...

N. N.

Të famshmit që vdiqën në mënyrë misterioze

Vdekje natyrale apo komplot? Kurrë nuk është njohur arsyeja e vërtetë e vdekjes së disa personazheve shumë të famshëm. E pabesueshme, shokuese dhe e habitshme. Kështu mund të përshkruhen vdekjet e disa prej VIP-ave gjatë historisë. Versioni zyrtar ekziston, por teoritë surrealiste vazhdojnë të ushqehen me fakte shumë vite pas vdekjes së tyre. Pse? Sepse, kanë qenë shumë të famshëm dhe vdekja e tyre e papritur ka qenë e lidhur me situata ekstreme.




MARILYN MONROE

Versioni zyrtar flet për mbidozë, por të afërmit e saj raportuan se vdekja e saj kishte qenë vrasje.

BRUCE LEE

Zyrtarisht ai vdiq nga një aneurizëm, por teoritë tregojnë për një vrasje.



ELVIS PRESLEY

Këngëtari u gjet i pavetëdijshëm në dysheme në të njëjtën ditë kur ai duhej të largohej nga Memphis. Teoritë tregojnë për vetëvrasje për shkak të numrit të sëmundjeve të pësuar.



PRINCESHA DIANA DHE DODI AL-FAYED

Paparacët që i ndoqën u fajësuan për vdekjen e tyre, por Mohamed Al-Fayed tha se vdekja e të dyve ishte një komplot kundër princshës së Uellsit.



MICHAEL JACKSON

Ka shumë teori në lidhje me vdekjen e tij: nga neglizhenca mjekësore në vetëvrasjen e mbretit të popit.



TUPAC SHAKUR

Ai mori disa të shtëna nga një makinë dhe ende nuk dihet se kush e vrau. Shenjat tregojnë për luftën e bandës.


KURT COBAIN

Këngëtari i Nirvanës bëri vetëvrasje me një të shtënë në kokë, por detektivi privat, Tom Grant, i punësuar nga Courtney Love, tregon për vrasje.



BRITTANY MURPHY

Ajo vdiq nga pneumonia dhe, muaj më vonë, burri i saj u gjet, gjithashtu, i vdekur. Pas disa analizave mjedisore të shtëpisë dhe trupit të aktores u gjetën disa metale helmuese. Nuk dihet nëse ishte vrasje apo vetëvrasje.



JAMES DEAN

Ai ishte i vetmi prej atyre të përfshirë në aksident që u lëndua, të tjerët mbetën të padëmtuar.

“Boom”

Pasionet e yjeve shqiptarë bëjnë çka nuk ua merr mendja!



ALTUNA SEJDIU

Altuna Sejdiu është një ndër këngëtares më të preferuara në trevat shqipfolëse, me hite tejet të suksesshme dhe shumë të dashura për veshët e dëgjuesve shqiptarë. Cili është hobi i Tunës? “E dua sportin dhe mundohem të bëj palestër rregullisht. I dua, në veçanti, sportet luftarake dhe shpeshherë mendoj se, nëse nuk do të isha këngëtare, do të vazhdoja të merresha me karate dhe, ndoshta, do të kisha sukseset e babait tim”, përfundon Tuna. Sidoqoftë, i ati i Tunës, Shaban Sejdiu, ishte kampion i mundjes, me disa tituj dhe medalje të çmuara në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare.

LEONORA JAKUPI

Pa dyshim, në listën e personazheve nuk mund të mungonte as këngëtarja e suksesshme, Leonora Jakupi, e cila tregon se preferon që kohën e lirë ta kalojë duke pikturuar. “Më pëlqen shumë të pikturoj. Më duket sikur bëhem pjesë e një bote tjetër. Një botë në të cilën unë udhëheq...”, deklaron ajo.



DAFINA ZEQRIRI

Këngëtarja Dafina Zeqiri tregon se ka hobi shëtitjet me shoqëri. “Sa herë kam nevojë të relaksohem, dal në shëtitje me shoqëri. Ndërsa, kur kam shumë kohë të lirë, shkoj në Suedi te familja ime”, përfundon Dafina.



ARGJENTINA RAMOSAJ

Për këngëtares Argjentina Ramosaj hobi më i madh mbetet fotografia. Megjithatë, nuk mbetet pas as modelingu. Një tjetër hobi interesant i këngëtares Ramosaj është të udhëtojë nëpër botë. “Kam shumë hobe, sa do të duhej një gazetë e tërë për t’i shkruar!”.



KASTRO ZIZO

Kantautori i njohur, Kastro Zizo, ka hobi peshkimin dhe gatimin. Ai ka treguar se gjen qetësi dhe relaks kur gatuan dhe kur është për peshkim.



EVI REÇI

Veç pasionit të madh që ka për muzikë, Evi Reçi ka pasion të madh edhe leximin.

Ajo pëlqen, gjithashtu, edhe të shkruajë. Natyrisht, nuk ka si të ndodhë ndryshe me një gazetare.

“Hobi, përveç muzikës, e që është e para në listë, kam edhe leximin. Më pëlqen që kohën e lirë ta kaloj duke lexuar dhe duke shkruar shpeshherë...”.

N.

Adelina Paloja, sopranoja që e prezantoi Kosovën në “Pantheon” të Romës

Adelina Paloja ka rrëmbyer audiencën me zërin e mrekullueshëm që e karakterizon. Zëri i saj, e që ngjallë magji, është i ngjashëm me zërin e engjëjve dhe ka arritur të përcjellë emocionet më të thella nëpërmjet interpretimeve të saj të mrekullueshme.

Adelina Paloja rrugëtimin e saj e filloi qëkur ishte 6 vjeçe, duke u regjistruar në shkollë dhe kurse për muzikë dhe për këtë meritë kryesor ishte babai i saj.

“Gjithçka nisi qysh në moshë të hershme, duke u evidentuar talenti dhe muzikaliteti në familje nga babai im si një artdashës, por edhe muzikant autodidakt aso kohe. Andaj, përveç muzikës tonë të përbashkët në ambientet e shtëpisë, ai mori mundin që të më udhëzoj në shkollim dhe edukim të më-tutjeshëm profesional në shkollë të muzikës qysh në moshën 6 vjeçe, kur konsiderohej akoma herët. Por, rrugëtimi im i nisur në moshë të re ka lënë gjurmë dhe themel të fortë në ndërtimin e mëtejshëm të identitetit tim artistik”, u shpreh Paloja.

E PARA NË KONCERTET NDËRKOMBËTARE

Ani pse fillimet ishin të vështira, sopranoja e njohur ia doli me ndihmën e familjes dhe të shumë figurave të rëndësishme të muzikës klasike.

Paloja është artistja e parë shqiptare në histori që arriti të jetë inter-



pretuese në koncertet më të mëdha ndërkombëtare.

“Kam qenë e lumtur të interpretoj në Milano dhe Lecco, në dy raste të rëndësishme që lidhen me figurën e ndritshme të popullit tonë, Shën Nënë Terezën...”

Të pranishëm ishin kontributdhënës nga Konsullata e Kosovës, Komuniteti shqiptar atje, e që na bëjnë krenarë përherë me të arriturat e tyre...”, tha ajo.

Gjithashtu, ajo ka interpretuar edhe në shumë vende të tjera të botës, si në Austri, Gjermani, Francë, Bullgari, Angli dhe shumë të tjera, ku në të gjitha nga këto vende e ka ndjerë energjinë dhe dashurinë e publikut për të, që në fund është frymëzuar të vazhdojë më tutje.

Vlen të theksohet se sopranoja Adelina Paloja është artistja e parë shqiptare, e cila ka interpretuar në “Pantheon” të Romës.

“Është absolutisht një ëndërr që të jetësohet interpretimi në vendin

më prestigjioz në Itali dhe botë, më saktë në Vatikan dhe në “Pantheon” të Romës, dy vendet me histori të jashtëzakonshme dhe të një rëndësie të veçantë për botën. Mund të them se nuk kishte si të kurorëzohej më mirë kalendari artistik...”, theksoi Paloja.

E LIDHUR EMOCIONALISHT ME FILARMONINË E KOSOVËS

Paloja eksperiencën e jashtëzakonshme ndër vite është duke e shprehur edhe si profesoreshë, por edhe si anëtare e Filarmonisë së Kosovës.

“Jam e lidhur emocionalisht me Filarmoninë e Kosovës, meqë angazhimi im në të është aktiv qëkur isha studente e vitit të dytë në Universitet...”

Sidoqoftë, Filarmonia është e kompletuar me të gjitha kapacitetet profesionale që dikur ishin deficitare. Andaj, jam e lumtur me këtë fakt, si dhe me prezantimet dinjitoze që pashmangshëm janë kudo që është Filarmonia me Korin dhe Orkestrën Simfonike Profesionale të saj”, potencoi Paloja për revistën tonë, “Kosovarja”.

Xheneta Spahiu



Kush janë nënat e yjeve tanë?



Të famshmit gjithmonë gjejnë rast të flasin për nënat e tyre, duke shprehur gjithë dashurinë dhe admirimin për to.

Disa nga këngëtarët shqiptarë, nënat i kishin mbështetëset më të forta në rrugën drejt suksesit.

Në "Boom" prezantojmë nënat e personazheve publikë, gratë që ndihmuan fëmijët e tyre të ngjiten suksesshëm shkallëve të suksesit...

D. H.

Numri i martesave në Kosovë në rënie. Pse?

Numri i çifteve të kurorëzuara në Kosovë ka shënuar një ulje të vogël në vitin 2022, krahasuar me vitin e mëparshëm, sipas raportit të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Statistikat e Kurorëzimeve për vitin 2022 tregojnë se numri i kurorëzimeve në territorin e Kosovës ka qenë 17.863, në krahasim me 18.131 kurorëzime të vitit 2021, e cila paraqet një rënie prej 1.5 për qind. Megjithatë, një fakt interesant është se numri i çifteve të kurorëzuara jashtë Kosovës është rritur në vitin 2022. Raporti tregon se ka pasur gjithsej 1.627 kurorëzime të regjistruara jashtë Kosovës, krahasuar me 1.566 të vitit 2021. Kjo paraqet një rritje prej 3.9 për qind në numrin e çifteve të kurorëzuara jashtë vendit.

MË SË SHUMTI KURORËZIME KA NË PRISHTINË

Sipas të dhënave statistikore, kurorëzimet në territorin e Kosovës kanë

ndodhur më së shumti në Prishtinë, ku janë regjistruar 1.718 kurorëzime, ose 8.8 për qind e të gjitha kurorëzimeve.

Prizreni është komuna e dytë me numrin më të madh të kurorëzimeve, me 1.537 raste, që paraqet 7.9 për qind të totalit.

Ferizaj renditet i treti me 1.133 kurorëzime, ose 5.8 për qind i të gjitha kurorëzimeve.

MARTESAT BËHEN, KRYESISHT, NDËRMJET MOSHËS 25-29 VJEÇ

Në lidhje me grupmoshën e personave të kurorëzuar, rezulton se meshkujt e grupmoshës 25-29 vjeç kanë pasur numrin më të madh të kurorëzimeve në vitin 2022.

Ndërkaq, te femrat, grupmosha me

numrin më të lartë të kurorëzimeve, ka qenë 20-24 vjeç.

Mosha mesatare e personave të kurorëzuar të regjistruar gjatë vitit 2022 është 29 vjeç.

Në përgjithësi, raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregon një rënie të lehtë në numrin e çifteve të kurorëzuara në vitin 2022, në krahasim me vitin e mëparshëm.

Megjithatë, numri i kurorëzimeve jashtë Kosovës ka shënuar një rritje të lehtë.

PËR FUND

Shtrohet pyetja: Pse kemi rënie të kurorëzimeve në Kosovë?

Të rinjtë në Kosovë po e shtyjnë martesën, thonë sociologët.

Djemtë, sipas tyre, po martohen, kryesisht, në moshën 30-vjeçare, e kjo po ndodh shkak se ata duan kushte më të mira ekonomike.

J A M B E R

LIFTING

I MENJËHERSHËM

PA DHIMBJE! PA KIRURGJI!




allure.
BEAUTY

+355 69 211 1919
@allurebeauty
Rr. "Reshit Çollaku", Tiranë

Si e mora burrin nga Prishtina pa e parë kurrë?

Jam e bukur dhe e mbaj veten, por burri nuk më prek me dorë se punon natën...

Në Angli kam ardhur me prindër menjëherë pas lufte. Tash jam grua e martuar, nënë e dy fëmijëve. Shkollimin e mesëm dhe zanatin për floktare e kam kryer gjatë kohës sa isha ende pa ardhur në Angli. Në zanatin tim jam shumë e përkushtuar dhe puna më shkon mirë.

SI E NJOHA BURRIN TIM?

Me kohë prindërit ma gjetën një burrë nga Prishtina, të cilin e pashë vetëm në fotografi. Në fillim nuk isha dakord, sepse nuk ishte tip imi. Por, pas shumë insistimeve të prindërve vendosa ta takoja në Prishtinë dhe ta shikoja ndryshe...

Në fillim kisha frikë, sepse mendoja se ishte vetëm për një aventurë e hiq më shumë.

Mirëpo, pas disa muajve më bindi se krejt çka më kishte premtuar edhe i realizonte...

Dhe, me pëlqimin e familjes u fejova dhe fillova ta doja si e çmendur...

Pas një viti ia mundësova marrjen e vizës, në cilësinë e bashkimit familjar. Në fillim isha paksa e rezervuar ndaj tij, por me kohë nisa të gëzohesha që e gjeta burrin e ëndrrave...

BURRI IM NUK E KALON NATËN ME MUA!

Por, e keqja ishte se ai e gjeti një punë ku gjithmonë ishte në ndërrimin e

natës, kurse unë natën e kaloja vetëm. Dhe, kur i thashë se po më mungon natën në shtrat, e la punën.

Por, as kjo nuk na bëri zgjidhje, meqë nisëm të keqësoheshim materialisht. Andaj, pas një kohe iu kthye të njëjtës punë ku ishte më parë...

Kështu, prapë nisëm të stabilizoheshim, derisa pas katër vjetësh mbeta shtatzënë me fëmijën e dytë. Në këtë kohë gjërat prapë nisën të ndryshojnë, e unë përsëri natën e kaloja vetëm...

Burri edhe më tutje më thotë se më do si i çmendur, kurse nuk bën asgjë për të ma dëshmuar...

Ndoshta kalon një muaj pa më prekur me dorë...

V. R., Angli

tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269336233 [/touristcamping_giovannisbeach](https://www.instagram.com/touristcamping_giovannisbeach)



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin www.touristcamping.me Tel: +38269825858 [/giovannis_beach_montenegro](https://www.instagram.com/giovannis_beach_montenegro)

Shqiptarja që tërë jetën e kaloi e virgjër!

Rrëfimi i burrneshës së vetme të Kelmendit: Ishim familje e madhe, tani shtëpia është zhytur në heshtje...

Gjystina Grishaj është burrneshë e vetme në Malësinë e Kelmendit. 54 vitet e jetës i ka kaluar në Lëpushë, aty ku u betua të bëhej shtylla e shtëpisë. Prej afro tri dekadash ajo drejton traktorë, shkon në mal për dru dhe kujdeset për bagëtinë. Sipas një tradite të lashtë, Gjystina është cilësuar si një ndër të fundit nga "virgjëreshat e betuara" të Shqipërisë.

PSE BURRËRESHËS NUK I LEJOHET SEKSI?

Kjo traditë e detyron atë të heqë dorë nga marrëdhëniet seksuale, jetën bashkëshortore dhe prindërimin, në

këmbim të së drejtës për të jetuar dhe punuar si burrë në shoqërinë thellësisht patriarkale.

Me babanë e saj të sëmurë dhe vëllanë e madh që ishte larguar nga jeta, ajo përqafoi identitetin si "burrneshë" e shtëpisë.

Tani ajo ka mbetur vetëm...

"Vendosa të punoj si burrë për të ndihmuar në arsimimin e motrave dhe vëllezërve të mi dhe mjekimin e babait tim.

Mirëpo, pas gjithë sakrificave që kam bërë për familjen time, është vetmia që më rëndon. Kanë qenë shumë prej nesh që jetonim në këtë shtëpi të madhe, e cila tani është e zhytur në heshtje.

Jam e pushtuar nga pikëllimi", thotë ajo.

NË MOSHËN 23-VJEÇARE U BETUA PËR VIRGJËRI TË PËRJETSHME...

Dikur shumë vajza bënin betimin e Burrneshës, kur kullat e tyre nuk kishin më meshkuj.

E, e vetmja mënyrë që dera të mbetej hapur ishte Betimi i Virgjëreshës së Përrjetshme.

Po, për Gjystinën apo Dunin, siç e thërret e gjithë Malësia, vendimi për t'u bërë burrneshë në moshën 23-vjeçare erdhi për arsye të tjera, të cilat i përmendëm më lart.



Chill Out
• BY THE POOL •


MARITIM
MARINA BAY RESORT & CASINO



Pse meshkujt ia "trusin" gjumë pas seksit?

Me orgazmën, një mori hormonesh çlirohen nga truri që redukton stresin dhe nxit relaksimin. Megjithatë, janë meshkujt ata që e manifestojnë më shumë këtë efekt. Si ka mundësi?

"Hormoni që lëshohet kur arrihet orgazma", shpjegon Dr. Sue Carter, "është i lidhur me reduktimin e stresit, reduktimin e mbrojtjes dhe nxitjen e palëvizshmërisë së patrembur. Të shtrihesh natën dhe të mos e kesh trurin të zënë, duke menduar për problemet ose gjërat që duhet të bësh të nesërmen, është gjendja ideale për gjumë cilësor".

ROLI KRYESOR I PROLAKTINËS

Prolaktina luan një rol kyç në këtë proces, i cili nga njëra anë nxit një gjendje përgjumjeje dhe nga ana tjetër një rënie të ngjalljes pas seksit.

Njerëzit me nivele më të larta të prolaktinës janë zbuluar se kanë përgjumje më të madhe gjatë ditës, duke sugjeruar një lidhje të fortë midis hormonit dhe nevojës për gjumë. Studimet, në fakt, kanë treguar se ndjenja e gjumit mund të ndodhë edhe me masturbimin, edhe pse përgjigja hormonale përmirësohet kur bën seks me një partner, pasi ndjenjat e afërsisë dhe intimitetit që favorizojnë gjumin hyjnë, gjithashtu, në lojë.

PSE NDODH MË SHUMË ME MESHKUJT?


Shkenca ka treguar se përgjumja pas seksit është më e shpeshtë te mesh-

kujt sesa te femrat, gjë që përputhet me stereotipin se meshkujt bien në gjumë shpejt pas seksit. Sipas disa studuesve, ky ndryshim mund të jetë për shkak të hendekut të orgazmës që i referohet faktit se, mesatarisht, femrat e arrijnë orgazmën shumë më rrallë se meshkujt. Kjo nuk është një legjendë, por një fenomen social konfirmojnë shifrat. Ndërsa, mbi 90 për qind e meshkujve, zakonisht, arrijnë orgazmën gjatë seksit, më pak se 50 për qind e femrave përjetojnë rregullisht orgazëm gjatë seksit, dhe vetëm 6 për qind arrijnë gjithmonë një orgazëm gjatë marrëdhënieve seksuale.

Fortesa
BOUTIQUE




Adresa: Rruga B. Kompleksi Royal C15/C16
10000 Prishtinë - Kosovë

 /fortesa__boutique

Kontakti: +38349641000

Adresa: Prishtina Mall,
Kati I

 /fortesa_prishtinamall

U bëra prostitutë që ta shkolloja vajzën!

Një nënë nga Prishtina, që ka ushtruar prostitucion shkaku i varfërisë dhe tash e ka lënë e nuk merret më me atë punë, i bën apel gjyqtarit: “I nderuari zoti gjykatës, jam marr me këtë punë që ta shkolloj vajzën time gjimnaziste, e që është nxënëse e shkëlqyeshme. Mos më dëno! Bëje këtë lëshim për vajzën time e jo për mua!”.

Nëse rrëfimi në vazhdim do të ishte një shkrim letrar, kjo gjë do na e kujtonte kohën e Migjenit dhe prozën “A do qymyr zotni?”.

Ka më shumë se një shekull që është shkruar kjo prozë e realitetit shqiptar. Dhe, pas një shekulli të asaj kohe, edhe sot m’u kjo problematikë është aktuale ende në Kosovë.

Andaj, në kuadër të kësaj drame jetësore, revista jonë sjell një rrëfim rrëqethës të një nëne, e cila shkel në nderin e vet për ta shkolluar vajzën e vet dhe për t’i siguruar ekzistencë. Rruga e filluar prej saj, për fat, ka qenë e shkurtër, sepse është kapur në vepër dhe ndaj saj lënda ka shkuar në gjykatë, nga edhe e ka marr dënimin dhe më nuk merret me këtë punë.

SI E PA AJO VETEN?

“Nuk gjetëm punë as unë e as burri, andaj u detyrova ta shes trupin. Por, rashë në kurth dhe më nuk merrem me atë punë”, thotë ajo dhe vazhdon: “E keqja më e madhe që mund t’i kanoset një njeriu, por edhe një familjeje, është varfëria. Varfëria më ka shtyrë të merrem me gjëra të tilla,

sepse ne patëm varfëri të skajshme në familjen tonë.

Nuk ke bukë, nuk ke gjëra që i duhen familjes, andaj fëmijën nuk mund ta shohësh duke pasur rregullisht mangësi e mungesa ushqimore. Nuk mund të dalësh me fëmijë në qytet, shembull, e të mos kesh një euro t’i blesh ndo gjë, siç blejnë ata që kanë.

Nuk mund të dalësh me fëmijë duarthatë përballë të tjerëve që hanë e pinë...

Nuk mund të mos jesh e ndjeshme ndaj fëmijës që shkon në shkollë pa libra e fletore, përballë të tjerëve që i kanë të gjitha dhe çantat plot.

E, kjo gjë më ka ndodhur mua dhe më ka shtyrë të merrem edhe me punë që kurrë nuk i kam dashur.

Unë një kohë të gjatë jam munduar të gjej punë, por ka qenë e kotë.

Por, kush i gjen punë një të varfëri?

Kush e do të varfrin?

Vajza ime është nxënëse e shkëlqyeshme e gjimnazit. Jeta ime është e lidhur me të...

Kisha dëshirë të mos dallohej nga shoqet sa u përket librave e fletoreve”.

E PEZMATUAR NË SHPIRT!

“Dhe, duke qenë në këso gjendje, e nisa atë rrugë e vetëdijshme se është gjëja më e shëmtuar për një femër, e edhe më e shëmtuar për një nënë.

E, unë jam edhe femër edhe nënë. Shpesh kam menduar se si jam katandisur në këtë gjendje dhe kam luftuar me vetveten për rrugën e nisur. Kthehesha në shtëpi me lot në sy, duke i thënë vetes se nuk duhej të hyja në këtë kasolle.

I bëja vetes pyetje:

Pse e nisa këtë rrugë?

Po ta kuptoj vajza ime punën time ku do të mbetëm unë?

Andaj, edhe i thashë gjyqtarit:

“Mendo për gjendjen time!

Mendo për kasollen time prej një dhome!

Mendo për vajzën time gjimnaziste!

Mendo për bashkëshortin tim të sëmurë që jeton në skamje!

Bëj lëshim për vajzën time e jo për mua!”.

S. K.

Contact numbers

 Prishtina, **Kosovo**
+383 45 224 540

 Prizren, **Kosovo**
+383 43 900 902

 Gjilan, **Kosovo**
+383 45 505 043

 Gjakova, **Kosovo**
+383 44 545 444

 Tirana, **Albania**
+355 69 465 55 59

 Durrës, **Albania**
+355 69 465 55 59

 Skopje, **Macedonia**
+389 70 255 581

 Hamburg, **Germany**
+49 176 40497246


 Bochum, **Germany**
+4915 901 352072

 Stuttgart, **Germany**
+4916 097 982 114

 Weil am Rhein, **Germany**
+49 173 1830732

 Olten, **Switzerland**
+41 76 402 85 85

 Brussels, **Belgium**
+32 49 207 50 48

 Sarpsborg, **Norway**
+47 98888845

 Michigan, **USA**
+1 248 677 2342



Rinjohja pas 40 vjetësh me anë të ombrellës së kuqe

Kthehem ndonjëherë në kohët pa kthim të rinisë. Atëbotë kur moshja nuk të jepte mjaftueshëm vezullim për të kuptuar stihinë e jetës së vrullshme.

Kur mbaruam klasën e tetë, përveç letrave shkollore të përfundimit me sukses të pjesës arsimore të edukimit fillor, duhej edhe një karakteristikë e Rinisë Socialiste, që dëshmonte përkushtimin për shtetin që nuk ekziston më.

Dhe, po t'mos e takoja para pak ditësh Mufon e brezit tim, nuk do më kujtohej kjo ngjarje.

Ai ishte zgjedhur kryetar i rinisë së shkollës dhe ishte autorizuar nga shkolla që të jepte karakteristikën e përshtatshmërisë politike.

E, kur u hapë kjo temë, më kaloi një pyetje nëpër kokë: Nuk di pse nuk e kisha pyetur Mufon se çfarë kishte ai më shumë se unë? Ishim nxënës të një klase, luanim top bashkë, hanim e pinim bashkë në shitoren e fshatit sa herë që njëri prej nesh kishte para, kurse ai ishte bërë tipi më i rëndësishëm i shkollës.

Dhe, kur u regjistruam të dy në shkollën e mesme teknike në Ferizaj, u bëmë të njohur në qytet që i ndiqnim vajzat e bukura. Madje, ishte në modë me i ndjek vajzat e bukura...

Në vitin e parë kishim frikë nga profesorët

kur i takonim në rrugë, sepse të nesërmen të pyesnin për notë, duke thënë: "Hajt ti që po ke kohë me shëtit rrugëve!".

E, ajo që më habiste ishte fakti se në klasë kishte nxënës me mbiemra edhe qesharake: Viqa, Goxhufi, Karpuzi etj.

THASHETHEMET RINORE PËR OMBRELLËN E KUQE

Një ditë, në klasën time, si rrufeja, "zbarkoi" para meje një vajzë e gjatë, që ma zgjati dorën për njoftim.

Ajo vinte nga një klasë tjetër e vitit të parë. Dhe, krahas përsëritjes, ndërruam edhe pak fjalë.

E, mu ato fjalë mjaftuan te shokët e klasës për t'u bërë thashetheme se unë, katundari, krijova raporte të ngushta me vajzën qytetare...

Ajo ishte, të paktën, një pëllëmbë mbi mua për nga gjatësia trupore, por nuk e dija se çfarë kishte gjetur të mirë te unë, e që nisi të shoqërohej me mua.

Ndoshta i bënte përshtypje xhemperi i gjelbër me vijë të kuqe në mes që e vishja çdo ditë, sepse xhemper tjetër nuk kisha, apo ora që e bartja në dorë, e që ma pat blerë babai që të mos vonohesha për në autobus e mësim.

Apo, flokët ngjyrë kafe, që rrallë i krijja, sepse e kishin formën e vet natyrore. Dhe, një ditë, pas përfundimit të mësimt, teksa u nisa për në stacion të autobusëve, nisi një shi i fortë.

Për çudi, në ato çaste, në rrugë e pashë vajzën e shkollës që shoqërohej me mua... Por, për dallim nga unë që isha bërë qull, ajo kishte ombrellë, madje ombrellë të

kuqe, e që të rralla ishin ato që kishin ngjyrën e tillë dhe, pasi m'u afrua, më tha: "Hyr nën ombrellë se qenke bërë qull!".

Dhe, teksa ecnim pranë njëri-tjetrit, më tregoi se ku e kishte shtëpinë dhe vazhduam bashkë deri te porta e shtëpisë së saj, e që në ndarje ma dha ombrellën e kuqe që të mos lagesha, sepse stacioni i autobusëve nga aty ishte goxha larg.

E, të nesërmen kur ia ktheva, në klasë filuan thashethemet për ombrellën e kuqe... Dhe, kështu, kaloi viti i parë, madje edhe i dyti, kurse miqësia jonë bëhej gjithnjë e më e madhe.

Por, në vitin e tretë nuk erdhi në shkollë. Flitej se ishte martuar, madje për profesorin e fizikës!

Dhe, që nga ajo kohë më nuk më etiketonte askush, por merakun për të sa vinte e më shtothej...

RINJOHJA, SHKAK OMBRELLA E KUQE...

Ishte verë e nxehtë bregdetare, kohë kur isha për verime në Ulqin. Me vete e kisha edhe një top voleybolli, me të cilin luaja me fëmijët e mi në plazh.

Dhe, teksa luanim, topi në një moment u rrokullis dhe u ndal në këmbët e një zonje. I thashë ta hidhte kah unë...

Zonja, posa i fola, ngriti kokën dhe më shikoi me kureshtje.

Dhe, pas pak, nga goja nxori fjalët "Ombrella e kuqe".

"Po", i thashë. "Por, nga dita kur humbe ti, shumë shiu është derdhur mbi kokën time në mungesë të ombrellës së kuqe..."

Sokol Murturi



Savor the joy of finding
it all in one place...



KOMPLEKSI DARDANIA
Lagjja Dardania, Prizren

+383 48 450 888 | www.cimaks.com

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A kemi magji në banesë?

Përshëndetje zonjë, jam një nënë e tre fëmijëve, jetoj në Zvicër.

Problemi ynë familjar është banesa në të cilën jetojmë. E gjithë familja shohim ëndrra tepër të trishtueshme...

Ne e dimë se njerëzit shohin ëndrra, por këtu gati jemi traumatizuar. Shpesh kemi edhe probleme mes vetes për shumë gjëra që na ndodhin... Dhe, duke të bërë lutje të mos i botosh të dhënat, na trego çka sheh syri yt në banesën tonë.

A kemi magji apo ka diçka në banesë që nuk po na lë të rehatohemi?

"Nëna e shqetësuar"

Përgjigje:

Ju jeni banorë të vjetër në shtetin Helvet dhe keni ndër-ruar shumë banesa e askund nuk keni pasur probleme. Kjo do të thotë se diçka nuk është në rregull me banesën tash. Ju e keni kontraktuar atë banesë që një vit, e aty ka jetuar një familje tjetër, e cila ka lënë në të diçka të dyshimtë. Nën parketin e dhomës së

fëmijëve, atje ku ndodhet shtrati dykatësh, është një pjesë parketi pak më i dalluar se të tjerët. Hiqni atë pjesë dhe keni për të gjetur diçka në dy qese najloni. Largojini nga dhoma dhe familja do të bëjë gjumë të rehatshëm.

Si ta largoj burrin për një kohë?

Jam zonjë, 34-vjeçare, jetoj jashtë Kosovës. Kemi një fëmijë në jetën bashkëshortore, por burri është i dhënë vetëm për punë dhe asgjë më shumë.

Unë jam lodhur me të dhe dua që ai të distancohet një kohë prej meje.

A mund të ndodhë kjo?

"Izmirja"

Përgjigje:

Arsyeja që po kërkon ti për distancim të burrit për një kohë, siç thua ti, është se ti je në lidhje me një burrë turk që punon me ty. Lidhja juaj ka hy thellë në dashurinë tuaj, prandaj je në situatë që ti sot nuk e ndjen të pranishëm në jetën tënde burrin tënd.

Ke marrë turr pas turkut dhe kjo mund të të kushtojë jo vetëm me ndarje, por edhe me pasojë. Sado që ti mendon se burri shkaku i punës të ka lënë pas dore, kjo nuk është e vërtetë. Puna është punë dhe bazë ekzistenciale për ju si familje, plus burri dërgon mjete financiare te prindërit, vëllai dhe motra në Kosovë, gjë që e dëshmon shpirtin e tij të madh për familjen, ndërkohë ty nuk të intereson fare kjo pjesë humane, sepse ti je verbëruar pas burrit të huaj nga Turqia. E, nëse e kupton burri yt këtë lidhje, do të jetë çmim i shtrenjtë për ty. Andaj, ktheju familjes!

A do të heqë dorë burri prej meje?

Zonja magjistare, ju përshëndes nga zemra! Jam 38-vjeçare, jetoj larg Kosovës. E kam një fëmijë. Burri nuk jeton me mua, por në Kosovë. Ka kohë që ai më paralajmëron për ndarjen tonë. A do të ndahemi?

"BZ"

Përgjigje:

Bashkëshortësia ka kuptim kur çifti jeton bashkë dhe ndanë problemet e përditshme së bashku. Ju e keni fëmijën, por ai nuk jeton me babanë e vet, ashtu qysh nuk jeton as ti me personin që e ke burrë. Fakti se ai paralajmëron ndarjen, do të thotë se ju i mungoni njëri-tjetrit dhe se nuk jetoni si burrë e grua.

Këtu mungon interesimi juaj për të jetuar bashkë. Ose ti nuk e merr në shtetin ku je me dokumente të rregulluar, ose ai nuk do të jetojë me ty atje. Kështu, si jeni aktualisht, nuk ju shoh bashkë.

Jam duke bashkëjetuar me të fejuarin, pse mërzhiten prindërit e mi?

Jam nga një fshat i Pejës, vajzë 23-vjeçare, në studime master në Prishtinë.

Kam të dashur, me të cilin jemi duke bashkëjetuar qe dy vjet. Kemi shpesh mosmarrëveshje, por e di se më do.

Por, e kam një brengë, po mërzhiten prindërit e mi...

“Pa shifër”

Përgjigje:

Ju nuk e keni bërë zyrtare lidhjen tuaj. Nuk jeni fejuar akoma dhe duhet ta dalloni fejesën dhe aktin e fejesës me një mbyllje në banesë me qira larg rrethit tuaj.

Fejesa është akti i zyrtarizimit të një lidhjeje. Është paramartese.

Jeni takuar në Prishtinë, jeni njohur, mund të flini së bashku në banesë me vite dhe në fund t’i thoni njëri-tjetrit nuk kemi mirëkuptim ndërmjet veti... Prandaj, kanë arsye të mërzhiten prindërit tu.

Dhe, ashtu si jeni ofruar edhe do të ndaheni...

Pse frikësohem natën?

Jam vajzë e pamartuar, 40-vjeçare. Kam pasur një dështim në dashuri dhe më ka lënë pasoja.

E, tani që ka kaluar ai lëndim nuk po bëhem rehat, sepse kam frikë natën, e cila më shfaqet më shumë gjatë gjumit pas mesnate.

Kam filluar të dyshoj se kam magji...

Si ta kaloj këtë problem?

“Vetmitarja”

Përgjigje:

Nuk ke magji, por devaluimi i kohës, duke qenë e vetmuar, e ka prodhuar këtë situatë kaotike te ti, pasi që ke ndjenja shumë të ngatërruara për momentin.

Je duke e mbajtur vështrimin te një person, i cili po ta merr gjumin dhe shpirtin, por është i martuar dhe nuk i ka rendet të të merr për grua.

Nuk them se nuk të do, por rrethanat tuaja janë të ndryshme dhe nuk ia vlen ta sakrifikosh shpirtin për dikë që nuk ka mundësi të të bëjë zgjidhje. Prandaj, duke qenë nën sundimin e vetmisë, nuk e bën gjumin rehat, sepse ke nevojë të jesh në shtrat me burrë.

Si e sheh të ardhmen time pranë burrit?

Jam zonjë 33-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Një kohë kam qenë jashtë Kosovës, por nuk kam mundur të bëj jetë atje, prandaj jam kthyer në vendlindje. Jam martuar vitin e kaluar. Si do ta kem jetën në të ardhmen dhe nëse ka mundësi ta përshkruani të kaluarën time...

“Era”

Përgjigje:

Nuk ju shoh pranë burrit. Je martuar me të pa e shëruar

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

plagën nga ndarja me burrin që ke jetuar në Gjermani.

E, gabimi qëndron mu aty se, të paktën, edhe dy vjet nuk është dashur të kishit bërë martesë.

Të martohesh me një burrë duke vuajtur për tjetrin me të cilin ke jetuar është krim shpirtëror, sepse nuk e bën të lumtur as burrin as veten.

Të vuash për dikë e ta vësh kokën në jastëk duke menduar për tjetrin është jorehabilituese. Shoh se së shpejti do të ndaheni...

A kanë magji fëmijët e mi?

Jam nënë e dy fëmijëve. Djali i madh më herët ka qenë i sëmurë nga magjia dhe e dimë saktësisht se atë e bërë halla e tij, sepse ajo merret me besime të tilla.

Dhe, nga ajo kohë frikë ka edhe vajza, e cila ikë prej hallës së vet...

A është e vërtetë kjo, apo ne jemi gabim?

“E brengosura”

Përgjigje:


Sipas asaj që shoh unë, djali ka pasur një problem të natyrës psikiatrike, pasojë nga frika. E, se halla i ka bërë magji kjo nuk është e vërtetë.

Sepse bijat mezi presin ta shohin mirë familjen e vet. Andaj, e ngarkoni pa nevojë hallën, sepse ajo nuk ka të bëjë me problemin as të djalit e as të vajzës.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE



Contact- Reception - +38260008002
tel. +38269610003 +38269607865
hotel.continental.ulcinj@gmail.com

 /hotel_continental_ulcinj

Disa nëna të suksesshme në familje dhe në karrierë publike

Paralelizmi mes punës dhe familjes për shumë figura publike nuk është edhe i lehtë.

Por disa zgjedhin të largohen nga profesionet për ti rritur fëmijët, e disa të tjera gjejnë kohë për të dyja njëkohësisht.

Disa nëna të suksesshme në karrierë dhe në familja janë këto:

ARBANA OSMANI

E Arbana është nënë e tre fëmijëve, të cilët nuk e penguan që ajo të zhvillohet dhe të ndaloj karrierën e saj. Arbana aktualisht mbanë një balancë mjaftë të mirë mes punës dhe familjes.



XHENSILA MYRTEZAJ

Për Xhensilën lindja e vajzës ishte çelësi në karrierën e saj artistike.

Ajo vitet e fundit është bërë një nga artistet më të kërkuara në bashkëpunime muzikore dhe në koncerte. Xhensila kohën më të madhe e kalon me vajzën e saj Ajkën. Kujtojmë që Xhensila është në pritje të fëmijës së dytë që do të jetë djalë.



LOREDANA

Loredana është një nga nënat më të komentuar të estradës.

Ajo pas ndarjes nga Mozziku, iu përkushtua maksimalisht edhe vajzës por duke mos e lënë anash edhe muzikën.

FIFI

Fifi ka pak muajt që ka marrë epitetin nënë me djalë Theo Mal. Fifi në muajt e shtatzanisë pati një motiv të madh, për të sjellë projekte të shumta. Ajo edhe pas shtatzanisë publikoi projektin e ri që u pëlqye shumë nga adhuruesit e saj.



ELITA RUDI

Elita Rudi është nënë e dy fëmijëve. Epiteti i nënës duket se Elitën e ka bërë edhe më të fortë. Ajo po gjen një balancë mes familjes dhe punës si moderatore dhe influencerë.



ADRIJANA MUSLIU-SHOSHI

Edhe fëmijët nuk po i ndalin gratë e suksesshme në politikë. Adrijana Musliu Shoshi, është një nga politikanet e para që ka marrë fëmijën me veti në mbledhje qeveritare. Pra, çdo nënë është një heroinë jo vetëm për fëmijët e vet por edhe për gjithë vendin. Edhe ato nëna që lënë punën për fëmijë, bëjnë një sakrificë të jashtëzakonshme për familjet e tyre dhe sigurojnë gëzojnë një respekt të madh.

ARJOLA DEMIRI

Arjola Demiri mund të cilësohet si heroinë për fëmijët e saj, për sakrificat që ka bërë për të arritur këtu ku është. Ajo tani ndihet nënë me fat, dhe një aktore tejet e kërkuar në projekte filmike.





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels



feel the legend

SHERWOOD
exclusive Kemer

SHERWOOD
exclusive Lara

SHERWOOD
Dreams Resort



SHERWOOD
Premia Hotel

GREENWOOD
Kemer Resort

GREENWOOD
Suites Resort

www.sherwoodhotels.com.tr